



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 11453 prot.,

Vlorë, më 18.07.2024

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ datë ____ . ____ 2024

PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIT TË QIRASË QË PËRFITOJNË FAMILJET DHE INDIVIDËT E PREKUR NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “LIDHJA E RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME SUPERSTRADËN FIER -VLORË”, SIPAS VKM NR.254, DATË 09.05.2018 .

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 2 pika 34, 42, 44, 45, neni 3, neni 33, neni 38, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.254, datë 9.5.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr.58 datë 21.01.2015 “Për trajtimin e disa familjeve që preken nga zbatimi i projektit “Lidhja e rrugës Transballkanike me superstradën Fier-Vlorë” me programe sociale të strehimit” të ndryshuar”, pika 1-b/1.1 dhe 1.2, të VKM Nr.362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike;

V E N D O S I

- I. Të miratojë subvencionin e qirasë, që përfitojnë familjet dhe individët e prekur nga zbatimi i projektit “Lidhja e rrugës Transballkanike me superstradën Fier-Vlorë”, sipas VKM Nr.254, datë 09.05.2018 (tabela bashkëlidhur).
- II. Efektet financiare sipas pikës 1 do të mbulohen 50% nga buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2024 dhe 50% nga Enti Kombëtar i Banesave.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe Enti Kombëtar i Banesave, Dega Vlorë .
- IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.

KRYETAR
Ermal Dredha



LISTA E FAMILJEVE QË KANË APLIKUAR PËR TË PËRFTUAR SUBVENCIONIN E QIRASË PËR VITIN 2024, SIPAS VKM NR.254, DATË 09.05.2018

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Përberja familjare viti 2024	Sipërfaqja m2	Të ardhurat mujore "A"	Qiraja mujore llogaritur nga EKB "Q" lek/muaj	Qiraja e përballueshme Qp lek/muaj	Subvencioni mujor "S" S=Q-Qp	Subvencioni vjetor 2024 5 x 12 muaj
1	Adem	Vero	Dëraj	2	65,6	39954	10,165	5,993	4,172	50,064
2	Sabri	Beqir	Ramaj	1	33,16	24730	8,290	3,800	4,490	53,880
3	Liljana	Demir	Dino	1	33,16	13421	8,290	2013	6,277	75,324
4	Xhane	Bino	Deshaj	1	33,16	13946	8,290	2,092	6,198	74,376
5	Hysri	Emin	Shehu	5	73,1	63419	18,275	9,513	8,762	105,144
6	Remzi	Faik	Kasaj	4	60,6	48567	15,150	7,285	7,865	94,380
7	Lumturi	Mehmet	Hoxha	1	33,16	11038	8,290	1,656	6,634	79,608
								Shuma	44,398	532,776

Shënim: Kjo shumë do të mbulohet 50% nga Enti Kombëtar | Banesave dhe 50% nga buxheti | Bashkise Vlorë për vitin 2024.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 11453 prot.,

Vlorë, më 18 . 07 .2024

RELACION

Për projekt-vendimin

PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIT TË QIRASË, QË PËRFITONJË FAMILJET DHE INDIVIDËT E PREKUR NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “LIDHJA E RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME SUPERSTRADËN FIER -VLORË”, SIPAS VKM NR.254, DATË 09.05.2018 .

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.254, datë 9.5.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr.58 datë 21.01.2015 ”Për trajtimin e disa familjeve që preken nga zbatimi i projektit ”Lidhja e rrugës Transballkanike me superstradën Fier-Vlorë” me programe sociale të strehimit” të ndryshuar , pika 1-b/1.1 dhe 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” neni 2 pika 34, 42, 44, 45, neni 3, neni 33, neni 38, të VKM Nr.362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, të shkresës Nr.1969/1prot., datë 23.10.2023 të Institutit të Statistikave, INSTAT mbi shpenzimet mesatare mujore për konsum për qarkun Vlorë sipas madhësisë mesatare të familjes për vitin 2022 dhe në përgjigje të shkresës së Entit Kombëtar të Banesave përcjellë pranë Bashkisë Vlorë me Nr.752prot., datë 22.05.2024 “Kërkesë për bashkëpunim mbi zbatimin e VKM Nr.254, datë 09.05.2018”, është hartuar projekt-vendimi për të plotësuar kërkesat për 7 familje dhe individë të prekur nga zbatimi i projektit të rrugës lidhëse Transballkanike me superstradën Fier-Vlorë, që kanë aplikuar për të përfituar subvencionin e qirasë për vitin 2024.

Subvencioni i qirasë që përfiton çdo familje $S = Q - Q_p$, ku

Q është qiraja që përcakton Enti Kombëtar i Banesave sipas çdo strukture familjare e konvertuar në qira banese të tregut të lirë,

kurse Q_p është qiraja e përballueshme.

Qiraja e përballueshme Q_p është në varësi të të ardhurave të familjes.

Të ardhurat familjare A, që përcaktojnë aftësinë paguese, vlerësohen si % ndaj të ardhurave të përcaktuara nga INSTAT për qarkun e Vlorës për vitin 2022, konkretisht me shpenzimet mesatare mujore për konsum të detajuara sipas madhësisë së familjes.



Qiraja e përballeshme Qp është 15% e të ardhurave totale mujore A për këto familje

$Qp=15\%A$.

Me të dhënat e nxjerra nga dokumentacioni i aplikantëve janë përpiluar formularët e vlerësimit të gjendjes ekonomike-sociale, të cilët i kemi përcjellë pranë Entit Kombëtar të Banesave, Drejtorive përkatëse në Tiranë dhe Vlorë, për përcaktimin e qirasë reale të tregut të lirë, sipas çdo strukture familjare.

Bazuar në vlerat e qirasë Q të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave kemi përcaktuar masën e subvencionit të qirasë që do të përfitojnë këto familje dhe individë, e cila do të përballohet 50% nga buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2024 dhe 50% nga Enti Kombëtar i Banesave. Vlerat gjenden në tabelën bashkëlidhur këtij projekt-vendimi të ndërtuar dhe të detajuar me të gjithë treguesit e duhur për përcaktimin e subvencionit.

Me këtë projekt-vendim i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Vlorë, të miratojë masën e subvencionimit të qirasë S, për ti ardhur në ndihmë familjeve për të përbaluar qiratë e tregut të lirë për banesat ku jetojnë me qira.

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 11453 prot.,

Vlorë, më 18.07.2024

MIRATOHET
KRYETAR

Ermal Dredha

VENDIM

Nr.4 , datë 15.07.2024

**PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PREKURA
NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “LIDHJA E RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME
SUPERSTRADËN FIER-VLORË”, SIPAS VKM NR.254, DATË 09.05.2018**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 2 pika 34, 42, 44, 45, neni 3, neni 33, neni 38, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.254, datë 9.5.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr.58 datë 21.01.2015 “Për trajtimin e disa familjeve që preken nga zbatimi i projektit “Lidhja e rrugës Transballkanike me superstradën Fier-Vlorë” me programe sociale të strehimit” të ndryshuar”, pika 1-b/1.1 dhe 1.2, të VKM Nr.362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”,

struktura përgjegjëse për strehimin pranë Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve paraqiti pranë Komisionit të Strehimit të Bashkisë Vlorë, të mbledhur në datën 15.07.2024

dokumentacionin dhe çdo material tjetër, kryesisht informacion mbi verifikimin në terren të banesave dhe kushteve të banimit, lidhur me familjet dhe individët, që janë prekur nga zbatimi i projektit “Lidhja e rrugës Transballkanike me superstradën Fier-Vlorë”. Komisioni

KONSTATOI SE:

Deri në datën 15.07.2024 kanë paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin 2 familje dhe 5 individë, ndërkaq theksojmë se disa familje të kësaj kategorie kanë përfituar nga ndarja e apartamenteve të ndërtuara nga EKB, pjesa e larguar në emigracion nuk përfshihet në këto aplikime, ndërsa një pjesë nuk kanë aplikuar për të përfituar nga fondet e parashikuara në buxhetet e Bashkisë Vlorë dhe të EKB për vitin 2024. Dokumentacioni i paraqitur është bazuar në VKM Nr.384,

datë 12.06.2019, duke vërtetuar kushtet e banimit dhe të strehimit, kushtet familjare, kushtet ekonomike dhe kushtet sociale të familjeve.

Duke shqyrtuar rast pas rasti të gjitha dosjet, u bë vlerësimi i të ardhurave dhe % që zënë këto të ardhura me të ardhurat e përcaktuara nga INSTAT për qarkun. Për familjet me të ardhura deri në 70% të të ardhurave mesatare, qiraja e përballueshme Qp është 15% e të ardhurave totale mujore të familjes A. $Qp=15\%A$. Subvencioni S që përfitohet nga familja dhe individët do të jetë $S=Q-Qp$, ku Q është qiraja që përcakton Enti Kombëtar i Banesave, kurse Qp është qiraja e përballueshme. Sa më lart komisioni;

VENDOSI

1. Qiraja e përballueshme dhe subvencioni për familjen dhe individët të jenë si vijon :

- Remzi Faik Kasaj, 4 persona, të ardhurat mujore neto, një pension dhe një pagë $A=48567$, aftësia paguese 15%, qiraja e përballueshme = 7285, subvencioni $S=q-Qp$
- Adem Vero Dëraj, 2 persona të moshuar, të ardhurat mujore neto, 2 pensione, $A=39954$ lekë, aftësia paguese =15%, $Qp=5993$ lekë, $S=Q-Qp$
- Liljana Demir Dino, 1 person në pension, $A=13421$ lekë, $Qp=2013$ lekë, $S=Q-Qp$
- Lumturi Mehmet Hoxhaj, 1 person në pension, $A=11038$ lekë, $Qp=1656$ lekë, $S=Q-Qp$
- Xhane Bino Deshaj, 1 person në pension, $A=13946$ lekë, $Qp=2092$ lekë, $S=Q-Qp$
- Sabri Beqir Ramaj, 1 person në pension, $A=24730$ Lekë, $Qp=3800$ lekë, $S=Q-Qp$
- Hysni Emin Shehu, 5 persona, $A=63419$ Lekë, $Qp=9513$, $S=Q-Qp$.

2. Këto përfundime të Komisionit të Strehimit do ti dërgohen me shkresë së bashku me formularët e vlerësimit të gjendjes ekonomike-sociale Entit Kombëtar të Banesave, Drejtorive përkatëse në Tiranë dhe Vlorë, për përcaktimin e qirasë reale të tregut të lirë, sipas çdo strukture familjare.

3. Më tej Bashkia Vlorë do të përcjellë për miratim pranë Këshillit të Bashkisë Vlorë, masën e subvencionimit të qirasë S për çdo rast, e cila do të përballohet 50% nga buxheti i Bashkisë Vlorë dhe 50% nga Enti Kombëtar i Banesave.

KOMISIONI :

1. Irena Toshkallari
2. Zambak Selmani
3. Dorian Demiri
4. Skerdilajd Hunda
5. Orest Ruçaj
6. Manuela Prifti
7. Donald Leskaj

8. Bledar Toja
9. Kanan Shakaj
10. Genard Fegaj
11. Selim Haskoçelaj
12. Birçe Aliraj
13. Drita Mustafai